



Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA NDRYSHE

*06 mars 2015, Prizren*

## **DEKLARATË**

“EC Ma Ndryshe po i përcjellë me shqetësim zhvillimet e fundit që lidhen me rastet e detyhuara të punësimeve jo të rregullta në shkollat e komunës së Prizrenit.

Qytetarët e Komunës së Prizrenit kanë të drejtë që të shprehin publikisht vullnetin e tyre për zhvillimet në pushtetin lokal, respektivisht në rastin konkret në sektorin e arsimit.

Zyrtarët komunal duhet të jenë të përgjegjshëm dhe llogaridhënës përballë publikut për të gjitha veprimet e tyre dhe gjendjen në arsim.

EC Ma Ndryshe konsideron se publiku duhet t’i shfrytëzojë të gjitha mjetet demokratike e qytetare, derisa autoritetet nuk zbardhin dyshimet.

Prandaj bën thirrje që protestat qytetare të jenë të qeta dhe demokratike.

Vetëm përmes mobilizimit të përgjithshëm shoqëror mund të ndalohet degradimi i mëtejshëm i sektorit të arsimit në Prizren dhe të sigurohet dinjiteti për punonjësit e arsimit dhe cilësia për nxënësit”.

OJQ EC Ma Ndryshe.